

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë, zoti Koçi përshkroi si e nisëm ditën sot, duke nderuar ata bij dhe ato bija të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë, që e çliruan këtë qytet, që e deshën lirinë europiane, që e deshën begatinë europiane, që e deshën progresin dhe prosperitetin european më shumë se jetën e tyre. Ishte detyra jonë e vogël, që t'iu jepnim atyre atë nderim që ata meritojnë. Zoti Koçi, la pa thënë, atë që jam i sigurtë që dhe ai e ka përjetuar, kur nga nderimi për heronjtë e Shqipërisë europiane, erdhëm dhe gjetëm pushtuesit e foltores këtu, të cilët progresraporti i përmend si kundërshtarët kryesorë të progresit european të Shqipërisë, pra nëse Shqipëria ka marrë një notë negative është nota që ne na japin kundërshtarët e progresit.

Nëse presidentja e Komisionit European do të ishte sot këtu, jam i sigurt se do të përsëriste atë që tha kur vizitoi Shqipërinë dhe që tha edhe ditën, kur Shqipëria zyrtarizoi negociatat. “Suksesi është juaji” u tha shqiptarëve, është suksesi e një pune vendçe, që kemi bërë për vite të tëra. Sot progresraporti u thotë shqiptarëve që keni ecur përpara. Patjetër mund të kemi ngelur në një kapitull pa lëvizur, por do të lëvizim, siç kemi lëvizur në 30 kapituj të tjerë. Patjetër që në disa prej kapitujt progresi është i tillë, që duket sikur po zvarritemi, por do të çohemi në këmbë, ashtu siç jemi ngritur në këmbë në kapitujt e tjerë dhe patjetër atje ku jemi duke ecur do të vazhdojmë të vrapojmë dhe më shpejt.

Po të shikoni kundërshtarët e progresit, pikërisht atje ku ne vrapojmë, pikërisht atje ku ne madje kemi nisur të fluturojmë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe me bashkudhëtarët tanë maqedonasit, atje ku ne jemi shkëputur, kundërshtarët e progresit janë dhe kundërshtarët më të ashpër, më të rreptë, bëhet fjalë për reformën në drejtësi. Merrni dhe vetëm lexoni deklaratat e kundërshtarëve të progresit european të Shqipërisë për reformën në drejtësi. Atje ku europeanët thonë: “Bravo ju qoftë për gjithçka që keni bërë, të gjithë së bashku, ju shqiptarët” ne dëgjojmë si merren me libër shtëpie të gjithë drejtuesit e gjykatave, gjithë gjyqtarët tanë.

Sot e nisëm ditën duke respektuar heronjtë e Tiranës, e cila, meqë ra fjala, në këtë vit është kryeqyteti european i rinisë, ndërkohë kur Tirana ishte nën drejtimin e kundërshtarëve të progresit european të Shqipërisë, as nuk e imagjinonin dot, nuk e imagjinonin dot që të konkurronin, jo më të ishin kryeqyteti european i rinisë. Vitin tjetër do të jemi kryeqyteti european i sporteve dhe do të vazhdojmë qërealitetin

europian ta sjellim çdo ditë këtu, ashtu siç po bëjmë me portin e Durrësit. Ne jo vetëm guxojmë ta mendojmë, ta projektojmë, ta hartojmë si portin europian të Shqipërisë, si një nga portet lider të Mesdheut, por do ta bëjmë atë gjë dhe ndaj juve na shikoni si kundërshtohet, sepse është projekti me europian që ne kemi pasur ndonjëherë për sa i përket menaxhimit portual, menaxhimit të turizmit, për sa i përket zhvillimit turistik.

Kështu që për atë çfarë ju, të dashur kolegë, shikoni, një pjesë e mirë e kolegëve të opozitës kanë qenë bashkëautorë në arritjet tona, se një pjesë e kemi bërë bashkë me ta, por unë jam duke folur për ata që e kundërshtojnë shpirtërisht dhe e kanë nxjerrë Shqipërinë prej zhelesh nga paradhoma e Bashkimit Europian që nga viti 1997, kur ishte përballë të gjithë shoqeve të saj të rajonit dhe sot vazhdojnë t'i varen nëpër këmbë dhe nuk duan në asnjë mënyrë ta lenë që ne të mbërrijmë rehat atje, ku neve na është mohuar për vite dhe shekuj të tërë. Faleminderit!